



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2020:110201

Datë: 24.02.2021

Numri i dokumentit: 01536353

**C.nr.919/2020**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, si kontestimore e përberë nga Gjyqtari individual Naim Mehulli, ne çështjen juridike te paditëses S.M nga Mitrovica, kundër te paditurës K... te cilën e përfaqëson avokati publik Komunal A.M, për shkak te kompensimit te pagave përcjellëse për ne pension pas mbajtjes se seancës kryesore me dt.22.02.2021, me dt.24.02.2021 nxjerr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. OBLIGOHET** e paditura K... t'ia paguajë paditëses S.M nga Mitrovica ne emër te 3 tri pagave përcjellëse për ne pension, shumen prej **1.434 €**, (**njëmijë e katërqind e tridhjetë e katër euro**), në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

**II. OBLIGOHET** e paditura K... t'ia paguajnë paditëses shpenzimet e procedurës në shumë prej **259 euro (dyqind e pesëdhjetë e nëntë euro)**, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

**A r s y e t i m**

Paditësja përmes te autorizuarit te saj Av.U.G me datën 08.09.2020 ka ushtruar padi për pagesën e shpërblimit jubilar, kompensim te tri pagave përcjellëse pas pensionimit dhe shujtave ditore konform nenit 35 par.7, par.8 dhe par.9 te Kontratës Kolektive te Arsimit ne Kosove dhe ne baze te dispozitave ligjore te Ligjit te Punës. Ndërsa shuma totale qe komuna duhet te paguaj është 2.954 euro ( dy mije e nëntëqind e pesëdhjetë e katër euro).

Gjykata me dt.22.02.2021, ka caktuar seancë për shqyrtim kryesor, ne te cilën ka prezantuar i autorizuari i paditëses dhe përfaqësuesi i të paditurës.

I autorizuari i Paditëses në këtë seancë përgjatë shqyrtimit gjyqësor dhe ne fjalën përfundimtare deklaroi se parimisht mbes pranë padisë dhe kërkesëpadisë, meqenëse paditësja shpërblimin jubilar e ka realizuar ne një procedurë tjetër, ndërsa sa i përket shujtave ditore është një padi tjetër pran kësaj gjykate atëherë TERHIQEMI nga kërkesëpadija për pagesën e shpërblimit jubilar dhe pagesave për shujta ditore, ndërsa mbetem pranë kërkesëpadisë për pagesën e pagave përcjellëse për pension, dhe bej precizimin e kërkesëpadisë sa i përket pagave përcjellëse për ne pension, ashtu qe ne emër te tri pagave përcjellëse kërkoj shumen prej 1.434 €, sepse lartësia e pagës se paditëses duke u bazuar n listën e pagës se Janarit 2020

është 478 € dhe ku e njehta shumëzohet për tri paga atëherë del shuma totale prej 1.434 €, gjykatës si prove ia dorëzojë vërtetimin lëshuar nga shkolla ku ka punuar paditësja e me te cilën vërtetohet se e njehta ka dal ne pension me dt.22.02.2020 po ashtu gjykatës i dorëzojë edhe listën e pagës për muajin Janar 2020 ne te cilën vërtetohet lartësia e pagës se paditësës. Shpenzimet e procedurës i kërkojmë dhe atë për përfaqësim ne një seance shumen prej 135 €, për përpilim te padisë shumen prej 104 € dhe për takse gjyqësore shumen prej 20 €.

Përfaqësuesi i të paditurës në seancë dhe ne fjalën përfundimtare deklaroi se nuk e kundërshtojë tërheqjen e padis për shujta dhe shpërblim jubilar, ndërsa sa i përket kërkesëpadisë se pagave përcjellëse e kundërshtoj si rezultat i mungesës se mjeteve financiare për këtë kategori. Nuk është kontestuese fakti se paditësja ka punuar tek e paditura deri ne ditën e pensionimit si dhe as lartësia e pagës mujore e saj.

Gjykata, ne procedurën e leximit te provave, referuar nenit 7 dhe 8, lexoi: Kopjen e letërnjoftimit për paditesen, Vendimi i lëshuar nga Ministria e Punëve dhe Mirëqenies Sociale dt.04.03.2020, Kërkesa drejtuar te paditurës dt.10.07.2020, Vërtetimi lëshuar nga Shkolla “...” Mitrovice dt.19.02.2021, Lista e pagës për muajin Janar 2020, pas shqyrtimit një nga një te këtyre provave dhe te gjithave se bashku gjykata konstatoi këtë gjendje:

Nuk është kontestues fakti qe paditësja ka qene në marrëdhënie pune te e paditura si mësimdhënëse mbi 16 vite, ky fakt vërtetohet në bazë vërtetimi për provojnë e punës lëshuar nga Shkolla e Fillore e Mesme e Ulet “...” Mitrovice i datës 19.02.2021, si dhe nga lista e pagës tek rubrika eksperienca e datës 01.01.2020.

Nuk është kontestues fakti se lartësia e pagës neto qe paditësja e ka realizuar nga e paditura para pensionimit është shuma mujore prej 478 euro (katërqind e shtatëdhjetë e tete euro) , ku kjo vërtetohet nga lista e pagës e datës 01.01.2020

Nuk është kontestues fakti se paditësës i ka pushuar marrëdhënia e punës për shkak të plotësimit të kushteve për pension të pleqërisë, e kjo vërtetohet nga vendimi i lëshuar nga Ministria e Punëve dhe Mirëqenies Sociale dt.04.03.2020.

Nuk është kontestuese se paditësja përmes te autorizuarit te saj ka paraqit kërkesë tek e paditura me date 10.07.2020 sa i parkete realizimit te kësaj kërkesë lëndore, kjo vërtetohet ne baze te njoftimit te paditurës te dt.05.06.2020.

Gjykata, lidhur me bazën e kërkesë padisë, iu referua nenit 35 par 9 të Kontratë Kolektive te Arsimit ne Kosove me numër te protokollit 2056 datës 18.04.2017, e cili ne nenin e lartcekur parasheh se “punëtorët të cilët dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri (3) pagave, sipas mesatares se tri pagave të fundit të punëtorit”. Ndërsa po i njëjti nen i kontratës se lartcekur, parasheh qe këto paga paguhen nga punëdhënësi i fundit dhe jo me larg se 30 ditë nga dita e pensionit, e qe ne rastin konkret nuk është kontestues fakti se punëdhënës i fundit i paditësës ka qen e paditura, sikur qe nuk është kontestues fakti qe e paditura obligohet qe brenda afatit 30 nga dita e pensionimit t’ia paguaj paditësit pagat përcjellëse, dhe nuk e ka përmbush këtë detyrim.

Gjykata, lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë, u referua në listën e pagës mujore te muajit Janar 2020 të paditësës , se paditësja ka marre pagën ne vlere prej 478 euro (katërqind e shtate dhjetë e tete euro).

Prandaj, gjykata bazuar ne nenit 35 par 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit të dt.18.04.2017 vendosi për kompensimin pas pensionimit shumën e përgjithshme prej 1.434 euro.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, për përfaqësim ne një seance shumen prej 135 €, për përpilim te padisë shumen prej 104 € dhe për takse gjyqësore shumen prej 20 €.

Gjykata, me rastin e vendosjes sipas dispozitivit si me lartë, pati parasysh edhe pretendimet e të paditurës të shprehura gjatë seancave gjyqësore, mirëpo të njëjtat gjykata me arsyet e cekura me lartë, i refuzoi si të pabazuara, duke iu referuar provave në shkresat e lëndës, ne bazë të të cilave u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata aktgjykimin e saj e bazoi në nenin 143 par 1 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**C.nr.919/2020 data 24.02.2021**

**GJYQTARI**  
*Naim Mehulli*

**UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit te këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj Gjykate.